



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal

01 Nr.06-9420/2

Dt.30.06.2015

Dragash

Na bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës“ nr.28/2008), nenit 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 i Ligjit 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme Komunave, si dhe nenit 32,2 të Statutit të Komunës- Dragash 01 Nr.06-103/1 të dt.11.09.2008, pas shqyrtimit paraprak të Kërkesës 01 Nr.312-8537 të dt.03.06.2015 të SHPK „Puna“-Prizren, për dhënien e Pëlqimit për ndërtimin e 1 (një) hidro-centralit në rrjedhën e „Lumit të Radeshës“, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.30.06.2015, miraton këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDËRTIMIN E 1 (NJË) HIDROCENTRALI

- I. JEPET PËLQIMI për realizimin e investimeve për ndërtimin 1 (një) hidro-centrali në pjesën nën fshatin Radeshë-Dragash, ashtu siç qëndron në Kërkesën e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
- II. Pëlqimi shërbon si bazë për fillimin e procedurave për sigurimin e pëlqimeve dhe lejeve tjera përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë lëmi, nga ministritë përkatëse dhe Zyra për Rregullatorin e Energjisë.
- III. Ndërtimi i hidro-centralit do të ndërtohet sipas projektit të hartuar e në vendin përkatës sipas Projekt-Skicës.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit-Dragash.
- V. Vendimi hyn në fuqi 15 dtë pas regjistrimit në protokolin e zyrës së MAPL-së, si dhe publikimit në web-faqen e Komunës-Dragash.

I dërgohet:

- SHPK „Puna“-Prizren,
- MAPL-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë,
- Drejtoratit për Urbanizëm, Planifikim, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit-Dragash, dhe
- Arkivit



Kryesuesi i KK-së

Aban Shabani